

VENDIM
Nr. 126, datë 27.2.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 420, DATË 26.6.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të shkronjave “a” e “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, dhe të nenit 20, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2, të vendimit nr. 420, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohen me lidhjet me të njëjtët numra dhe tituj, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vlerat e elementit “pagë bazë për gradë”, në lidhjen nr. 1, si dhe vlerat e elementit “pagë për titull akademik/gradë shkencore/kualifikim shkencor”, në lidhjen nr. 2, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5%.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore, për vitin 2026, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

[illegible]

**STRUKTURA DHE NIVELI I PAGAVE PËR USHTARAKËT AKTIVË TË PERSONELIT AKADEMIK,
NË AKADEMINË E FORCAVE TË ARMATOSURA**

Nr.	Grada ushtarake	Pozicioni	Paga për titull akademik/gradë shkencore/kualifikim shkencor	Masa e shtesës për kushte të veçanta ounë e shërbimi
1	Gjeneral Brigade/Major	Rektor me titullin “Profesor”	184,000	10,000
2	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zëvendësrektor, me titujt “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”	174,100	10,000
3	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zëvendësrektor, me gradën shkencore “Doktor(PhD)”	171,720	10,000
4	Kolonel (kapiten i rangut I)	Dekan me titujt “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”	174,100	10,000
5	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zëvendësdekan me titujt “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”	159,300	10,000
6	Kolonel (kapiten i rangut I)	Zëvendësdekan nga kategoria “Lektorë”	140,490	10,000
7	Kolonel (kapiten i rangut I)	Përgjegjës i njësisë bazë me titujt “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”	163,000	10,000
8	Kolonel (kapiten i rangut I)	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria “Lektorë”	140,490	10,000
9	Kolonel (kapiten i rangut I)	Titullar i grupit mësues - kërkues nga kategoria “Profesor”/ “Profesor i Asociuar”.	163,000	10,000
10	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Titullar i grupit mësues - kërkues nga kategoria “Lektorë”	140,490	10,000
11	Kolonel (kapiten i rangut I)	Profesor	159,300	10,000
12	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Profesor i Asociuar	138,400	10,000
13	Nënkolonel (kapiten i rangut II)	Lektorë	118,940	15,000
14	Major (kapiten i rangut III)	Asistent Lektorë	96,600	15,000
15	Kapiten Lejtnant)	Asistent Lektorë	87,700	15,000